



Komuna e Klinës
Kryetari i Komunës
01Nr. 112-36119 /2022
Klinë, dt. 19.10/2022

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare, më dt.04.06.2008, nr.28, dispozitat e nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, si dhe duke u bazuar në pikën 14 të Vendimit të QKR-së nr. 28/96 të datës 14.09.2022, Kryetari i Komunës së Klinës, mori, **këtë**

V E N D I M

Për caktimin e personit përgjegjës për kursim të energjisë

1. IZET MILAZIMI, nëpunës publik në kuadër të Drejtorisë së Administratës, **CAKTOHET**, person përgjegjës për kursim të energjisë në objektin e administratës komunale në Klinë.
2. Detyrat e personit përgjegjës janë si në vijim:
 - 2.1. Të ndal të gjitha dritat dhe pajisjet elektrike pas orës 16:00;
 - 2.2. Të ndale të gjithë ndriçimin i cili nuk është i domosdoshëm për siguri fizike të objektit gjatë natës;
 - 2.3. Të sigurohet që gjatë orarit të punës prej orës 08:00 deri në 16:00, temperatura për ngrohjen e hapësirave të jetë jo më shumë se 19 grade;
 - 2.4. Të sigurohet që pas orës 16:00 deri të nesërmen në ora 07:00 temperatura e ngrohjes të zbritet në minimum (kur ngrohja behet më energji elektrike) në rastet kur është e mundshme;
 - 2.5. Të sigurohet që të gjitha dritaret e objektit të jenë të mbyllura.
3. Personi përgjegjësi i caktuar plotëson rregullisht formularët për mbikëqyrje të masave detyruese për kursim të energjisë, më të cilët formular e njofton Drejtorin e Administratës i cili mbikëqyr zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Të përmendurit;
- Drejtoria e Administratës;
- Qeveria e RKS;
- Zyra e Informimit, si dhe;
- Arkivi.

